

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT TE NXENËSVE

Proçesi i Përzgjedhjes së Shkollës


Pyetjet më të Shpeshta nga Prindi i Shkollës Fillore/Tetëvjeçare

Kush duhet të marrë pjesë në Proçesin e Përzgjedhjes së Shkollës?

Proçesi i Përzgjedhjes së Shkollës është për nxënësit dhe familjet e tyre, të cilët dëshirojnë të aplikojnë për një shkollë **jashtë** zonës së tyre të banimit.

Cilat janë mundësitë e fëmijës tim?

Drejtoria Arsimore e Filadelfias (DAF) ofron shumë për nxënësit. Në tërësinë e saj, Drejtoria ka tre lloje shkollash, siç shtjellohen më poshtë.



Fëmija im po aplikon për një shkollë tetëvjeçare me pranim special? Çfarë duhet të bëj unë?

- PËR NXENËSIT AKTUALE TË DAF
 1. Aplikoni në shkollat që jeni të interesuar nëpërmjet sistemit online të Përzgjedhjes së Shkollës.
 2. Rekordet mësimore të fëmijës do të dërgohen automatikisht në shkollat e kërkuara, nëpërmjet sistemit të Përzgjedhjes së Shkollës, të Drejtorisë Arsimore.
 3. Disa shkolla kërkojnë një ese, intervistë, ose auditim. Ju lutemi vizitoni uebsajtet e shkollave, për rishikimin e të gjitha kërkesave specifike të tyre për pranim.
 4. Kontaktoni shkollat në raste kërkesash për intervista, ose auditimesh.
- PËR NXENËSIT QË NUK JANË AKTUALISHT NXENËS TË DAF
 1. Aplikoni në shkollat që jeni të interesuar nëpërmjet sistemit online të Përzgjedhjes së Shkollës.
 2. Shkollat me pranim special kanë kërkesa që lidhen me rezultatet, frekuentimin dhe sjelljen, kështu që ato kërkojnë kopje të të dhënave më të fundit të fëmijës tuaj, në këto aspekte.
 3. Ju duhet të paraqitni informacionin në vazhdim, në secilën shkollë ku keni bërë aplikim
 - Transkriptet e të dhënave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias
 - Kopje të testit më të fundit të standardizuar.
 - Tabela e mëposhtme do t’ju ndihmojë çfarë të përgatitni për paraqitje.

Aplikim për klasën e 5 ^{te}	Qasni informacion për rezultatet e testeve të standardizuara të klasave të 2 ^{ta} dhe 3 ^{ta}
Aplikim për klasën e 6 ^{te}	Qasni informacion për rezultatet e testeve të standardizuara të klasave të 3 ^{ta} dhe 4 ^{ta}
Aplikim për klasën e 7 ^{te}	Qasni informacion për rezultatet e testeve të standardizuara të klasave të 4 ^{ta} dhe 5 ^{ta}
Aplikim për klasën e 8 ^{te}	Qasni informacion për rezultatet e testeve të standardizuara të klasave të 5 ^{ta} dhe 6 ^{ta}

4. Disa shkolla kërkojnë një ese, intervistë, ose auditim. Ju lutemi vizitoni uebsajtet e shkollave përkatëse për rishikimin e kërkesave specifike të tyre.

Fëmija im ka aplikuar për shkollën e zonës, ose me pranim nga gjithë qyteti. Çfarë më duhet të bëj në këtë rast?
Shikoni listën e shkollave të zonës dhe atyre me pranim nga i gjithë qyteti në schoolselection@philasd.org. Aplikoni në shkollat që keni interes nëpërmjet sistemit online të Përzgjedhjes së Shkollave.

Si bëhet përzgjedhja e nxënësve për shkollën e zonës, ose me pranim nga gjithë qyteti?

Drejtori i shkollës konfirmon numrin e vendeve të shkollës. Pas kësaj personeli i shkollës fut emrat e nxënësve në një llotari kompjuterike, e cila bën përzgjedhjen në vartësi të vendeve të lira.

Kam dëgjuar se në rast se unë aplikoj në dorazi në një shkollë, shanset për pranim rriten. A është kjo e vërtetë?

Jo. Nxënësit përzgjidhen nga një llotari e kompjuterizuar, jo nga personeli i shkollës, ose drejtori. Kështu që nuk ka asnjë dallim nëse aplikimi bëhet dorazi, ose online.

A ka mundësi të rriten shanset e pranimit, nëse unë e bëj aplikimin sa më heret?

Jo.

Si e përcakton Drejtorja Arsimore listën e shkollave fillore dhe Tetëvjeçare të vlefshme për këtë proces?

Zyra e Regjistrimit dhe Pranimit të Nxënësve, në bashkëpunim me Zyrat e tjera dhe Drejtorët e shkollave, vlerëson cila shkollë ka vende të lira, (sipas viteve të klasave), për nxënësit që jetojnë jashtë zonës së shkollës. Në tërësi, personeli rishikon përdorimin e ndërtesës në vartësi të tendencës së pranimeve dhe faktorëve të tjerë, të cilët mund të jenë unikë për shkollën, ose zonën, të tilla si ndërtimet e reja që bëhen në zonë. Në rast se shkolla nuk paraqitet në listë, kjo lidhet me faktin se shkolla nuk ka asnjë vend të lirë për nxënësit, që banojnë jashtë zonës së shkollës, për vitin e ardhshëm.

A do të marrë transport fëmija im në rast se ai/ajo pranohet në një prej shkollave që ka aplikuar?

• Nxënësit K-6	Transporti nuk ofrohet
• Nxënësit 7-12	Transporti ofrohet për ata që jetojnë 1.5 milje larg shkollës, me <i>Student Transpass</i> .
• Nxënësit që janë zgjedhur në një prej shkollave më poshtë dhe jetojnë 1.5 milje larg shkollës, do t'u mundësohet transpas (<i>Student Transpass</i>), pavarësisht nivelit të klasës: GAMP, MYA, AMY Northwest, AMY at James Martin, Conwell, Hill Freeman and Masterman	

Cili është afati kohor për Procesin e Përzgjedhjes së Shkollës?

(Datat janë subjekt i ndryshimit)

Muaji	Aktiviteti
Tetor	Plotësohen Aplikimet
Janar-Shkurt	Vlerësimi i aplikimeve nga shkollat (shkollat me kritere pranimi)
Në fund të muajit Shkurt	Hidhen llotaritë
Mars	Dërgohen njoftimet fillestare për Statusin
Në fund të muajit Mars	Merren nxënësit nga lista e pritjes
Prill	Dërgohen njoftimet përfundimtare për Statusin

Si do të komunikojë Drejtorja Arsimore me mua?

- PËR NXENËSIT AKTUALE TË DAF – Të gjitha njoftimet do të dërgohen në familjet e nxënësve, nëpërmjet Portalit të Nxënësit dhe Prindit (Student and Parent Portals). Kjo përfshin dhe vendimet e marra të përzgjedhjes së shkollës.
- PËR NXENËSIT QË NUK JANË AKTUALISHT NXENËS TË DAF - Të gjitha njoftimet do të dërgohen në adresën e email-it të dhënë në aplikim. Kjo përfshin edhe vendimet e marra të përzgjedhjes së shkollës.

Në rast se fëmija nuk pranohet në shkollat që kam kërkuar, a ka ende mundësi që ai të regjistrohet?

Po. Llotaria që zbatohet nuk zgjedh vetëm nxënësit që do të pranohen, por krijon edhe një listë pritjeje (wait list) të nxënësve që nuk janë përzgjedhur. Këto rezultate të llotarisë ndahen me drejtorët e shkollave. Në rast se hapet një vend i lirë, shkolla do të pranojë nxënësit prej listës së pritjes.